

VENDIM
Nr.67, datë 2.2.2011

**PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË PROTOKOLLIT QË NDRYSHON ANEKSIN E SIGURISË
SË MARRËVESHJES, NDËRMJET PALËVE TË TRAKTATIT TË ATLANTIKUT VERIOR,
PËR BASHKËPUNIMIN NË LIDHJE ME INFORMACIONIN ATOMIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin, në parim, të protokollit që ndryshon aneksin e sigurisë së marrëveshjes, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut Verior, për bashkëpunimin në lidhje me informacionin atomik, bërë në Bruksel, më 2 qershor 1998.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PROTOKOLL
QË NDRYSHON ANEKSIN E SIGURISË SË MARRËVESHJES NDËRMJET PALËVE TË
TRAKTATIT TË ATLANTIKUT VERIOR PËR BASHKËPUNIMIN NË LIDHJE ME
INFORMACIONIN ATOMIK,

Duke pasur parasysh që zhvillimet në sigurinë e informacionit atomik kërkojnë rishikimin e shpeshtësisë së inspektimit të plotë të sigurisë të të gjitha elementeve ushtarake dhe civile të NATO-s dhe të shteteve anëtare që kanë marrë informacion në bazë të Marrëveshjes ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut Verior, për bashkëpunimin në lidhje me informacionin atomik, palët e poshtëshënuara kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Aneksi i sigurisë së marrëveshjes ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut Verior për bashkëpunimin në lidhje me informacionin atomik, bërë në Paris më 18 qershor 1964, ndryshohet sipas parashikimit në nenin 2.

Neni 2

Fjala e parë e seksionit X, inspektimet e sigurisë, paragrafi A, e aneksit të sigurisë së marrëveshjes ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut Verior për bashkëpunimin në lidhje me informacionin atomik, zëvendësohet me fjalinë e mëposhtme:

“A. Inspektimi i plotë i sigurisë të të gjitha elementeve ushtarake dhe civile të NATO-s dhe shteteve anëtare që kanë marrë informacion atomik sipas marrëveshjes kryhet rregullisht, gjatë një periudhe që përcaktohet nga Këshilli i Atlantikut Verior, në bazë të rekomandimit të Komitetit të Sigurisë së NATO-s, me kriteret e parashikuara në seksionin I, paragrafi A i këtij aneksi.”.

Neni 3

Ky protokoll hyn në fuqi me marrjen nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës të njoftimit nga të gjitha shtetet palë në marrëveshjen ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut Verior për

bashkëpunimin në lidhje me informacionin atomik, që ata kanë vullnetin t'u nënshtrohen termave të këtij protokolli.

Neni 4

Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës informon të gjitha palët dhe Organizatën e Traktatit të Atlantikut Verior për çdo njoftim dhe për hyrjen në fuqi të këtij protokolli.

Neni 5

Ky protokoll mban datën në të cilën është hapur për nënshkrim dhe mbetet i hapur për nënshkrim derisa të nënshkruhet nga të gjitha palët në marrëveshjen ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut Verior për Bashkëpunimin në lidhje me informacionin atomik.

Në dëshmi të kësaj, përfaqësuesit e poshtëshënuar kanë nënshkruar këtë protokoll.

Bërë në Bruksel, më 2 qershor 1998, në gjuhën angleze dhe frënge, ku të dyja tekstet janë njëlloj autentike, në një kopje origjinale të vetme që depozitohet në arkivat e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e cila u transmeton kopje të certifikuara të saj të gjitha shteteve nënshkruese dhe aderuese.